

## TAKIMI I KATËRT 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Mbledhja e katërt e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u mbajt më datë **17.12.2024**.

Mbledhja u hap me prezantimin e studimit të UNDP Albania për *“Ndikimin e digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*. Përfaqësuesja e UNDP Albania informoi se, studimi synonte të bënte një analizë të ndikimit që ka digjitalizimi në sektorët kyç të ekonomisë: energjia, TIK dhe turizmi. Përfaqësuesja e UNDP Albania tha se, prezantimi do të fokusohet tek metodologjia e studimit dhe tek një pyetësor për anketim që po realizohet me kompanitë në të tre sektorët.

Përfaqësuesja e UNDP Albania informoi se, ishin disa faza apo nivele që të thuhet që kompania ishte e digjitalizuar: - në nivelin e parë ishin ato kompani me infrastrukturë bazë digjitale; - në nivelin e dytë ato kompani që kishin sisteme të integruara të proceseve, - në nivelin e tretë dhe të katërt ishte modeli i biznesit të bazuar në produktet dhe shërbimet digjitale dhe përdorimin e teknologjive të përparuara. Përfaqësuesja e UNDP Albania tha se, për vlerësimin e nivelit ishte krijuar një sistem matës nga 0 në 100, i bazuar në mbledhjen e të dhënave. Nëpërmjet përgjigjeve të kompanive përcaktohet shkalla e digjitalizimit të secilës prej tyre. Përfaqësuesja e UNDP Albania informoi se, për momentin po zhvillohet faza e mbledhjes së të dhënave dhe se projekti synonte të grumbullonte të dhëna nga 100 kompani në total nga tre sektorët, të ndara sipas peshës: turizmi 50%, TIK 30% dhe energjia 20%.

Në vijim të mbledhjes, Sekretariati Teknik bëri një përmbledhje të përshkrimit të punës dhe detyrave kryesore për *“Menaxher eventesh”*, rezultat i një pune kërkimore. Nga diskutimet e anëtarëve rezultoi se, ky kualifikim ishte shumë i rëndësishëm për operatorët turistikë apo për kompanitë e eventeve dhe ndaj ishte i domosdoshëm ofrimi i një kualifikimi pas të mesëm për këtë profesion.

Mbledhja vijoi me diskutimin për *“Menaxher shërbimi në bar - restorant”* që dilte si nevojë në Studimin e Nevojave për Aftësi. Edhe për këtë profesion, Sekretariati Teknik kishte bërë një punë kërkimore për pozicionin e punës dhe detyrat që mbulonte. Sekretariati Teknik bëri një përmbledhje të detyrave kryesore dhe më pas u hap diskutimi mes anëtarëve. Nga diskutimet rezultoi se, ky profesionist ishte ai që garantonte cilësinë e operimit të pijeve dhe ushqimit. Anëtarët dolën në përfundimin se një menaxher për shërbimin e pijeve dhe ushqimit (menaxher i shërbimit në restorant) ishte një pozicion kyç dhe shumë i nevojshëm për rritjen e cilësisë së shërbimit. Anëtarët propozuan që të ofrohet një kualifikim pas i mesëm për: *“Menaxher shërbimi në bar - restorant”*.

### Vendime të marra nga mbledhja:

- Të ofrohet një kualifikim pas i mesëm për *“Menaxher eventesh”*.
- Të ofrohet një kualifikim pas i mesëm për *“Menaxher shërbim në bar - restorant”*.